



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.16

Prishtinë, më 3.6.2015 ora: 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

Procesverbal

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Shqipe Pantina, Pal Lekaj, Jelena Bontic dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Alma Lama.

Në mbledhje morën pjesë: Mahir Yagcilar, Ministër i MAP-së, Drejtori i zyrës ligjore në MAP, dhe përfaqësuesi i SIGMA-së, pjesëmarrës në hartimin e draft ligjit, Albulena Haxhiu. Përfaqësuesit e Zyrës së KE-së dhe OSBE-së.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina, Mirjeta Heta dhe Flaka Zairi, praktikante në komision, nga UNDP-ja.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.5 dhe 27.5.2015;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Procedurën e përgjithshme administrative;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.5 dhe 27.5.2015;

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Procedurën e përgjithshme administrative;

Zenun Pajaziti - e njoftoi ministrin Mahir Yagcilar për Projektligjin për Procedurën e përgjithshme administrative, se Drejtoria për Standardizim e Kuvendit të Kosovës ka hartuar raportin preliminar, në të cilin janë dhënë vërejtjet, propozimet për projektligj. Ai konfirmoi prioritetet që i ka projektligji, me të cilin do të bëhet një reformë në administratën publike, ndërsa për vërejtjet tha se do të mënjanohej në fazën e amendamentimit...

Mahir Yagcilar, ministër i MAP-it, duke falënderuar komisionin për gatishmërinë për bashkëpunim, theksoi se projektligji u dedikohet mbarë punonjësve të administratës, konform konceptit të një administrate të avancuar, përkatësisht sipas standardeve evropiane.

Me projektligj mundësohet realizimi efektiv i autoritetit efektiv në shërbim të interesit publik, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave.

Projektligji është një frymë e re e hartuar sipas standardeve evropiane, sipas së cilit mundësohen lehtësime në procedurën administrative. Për implementimin e ligjit Komisioni Evropian do të sigurojë mbështetje nëpërmjet – IPA-së 2014.

Gjithashtu ministri Yagcilar e njoftoi komisionin se teksti origjinal i projektligjit është gjuha shqipe. Ai propozoi që projektligji të miratohet në parim me të gjitha vërejtjet e identifikuara të cilat do të përmirësohen në fazën e amendamentimit.

Shqipe Pantina - tha se, Projektligji i procedurës administrative i Republikës Shqipërisë, të cilin po ashtu e ka hartuar SIGMA, është ligj jashtëzakonisht i mirë për dallim nga ky projektligj, i cili gjithashtu është hartuar nga SIGMA. Në tekstin e projektligjit gjuha është e paqartë, memorandum i shpjegues nuk jep arsye të detajuara për domosdoshmërinë e hartimit të projektligjit dhe ndryshimin e ligjit në fuqi. Meqë, me projektligj preken edhe fusha të tjera, ndoshta do të ishte më se e nevojshme që projektligji në Kuvend të adresohet në pako me disa ligje të tjera si p.sh. me ligjin për konfliktin administrativ.

Tek dispozitat e projektligjit – Qëllimi nuk qartësohet për çfarë arsye duhet të ndryshohet ligji në fuqi për procedurën administrative, për arsye se ka mangësi, sepse nuk implementohen apo mungojnë kapacitetet për zbatimin e tij. Ajo pastaj pyeti se gjatë hartimit të tekstit të projektligjit a janë konsultuar ekspertët vendorë dhe a janë marrë për shqyrtim komentet e ekspertëve vendorë.

- cili model është marrë (nga cili shtet) dhe pse pikërisht është marrë nga ai shtet; hyrja në fuqi e projektligjit a do të krijoj kolizion mes ligjeve?

Sa i përket çështjeve teknike nuk ka radhitje konform standardeve për hartimin e një ligji. Projektligji i mungojnë përkufizimet, disa nga parimet. Projektligji ka edhe implikime buxhetore dhe mbi bazë të këtyre vërejtjeve, ajo u deklarua se nuk do ta votojë projektligjin dhe propozoi që projektligji të kthehet në Qeveri për ripunim.

Pal Lekaj - tha se Projektligji për procedurën e përgjithshme administrative, është hartuar në tri gjuhë dhe do të duhej që këto tekste të harmonizohen gjuhësisht dhe përmbajtësisht.

Projektligji përmban terma dhe shprehje reciprokisht të paharmonizuara, madje në disa raste, në aspektin juridik -material, në kundërshtim me formulimet që i kultivon doktrina si dhe praktika juridike – administrative.

Parimet themelore të së Drejtës Administrative, përkatësisht të procedurës së përgjithshme administrative, kryesisht zbatohen përmes dispozitave në të cilat sublimohen në një anë si dhe çështjet administrative procedohen dhe vendosen në harmoni me domethënien e premisat e tyre, se do të duhej të definohej qartë e plotë nocioni i vendimit dhe i aktvendimit dhe të përcaktohej se kur vendoset çështja administrative me vendim e kur me aktvendim.

Ky Projektligj, sikundër edhe të tjerët, është i dobët edhe sa i përket terminologjisë dhe në shumë raste edhe përmbajtjesor, ashtu që në të, ka vend për më se qindra propozim – amendamente.

Xhevahire Izmaku - duke u pajtuar më vërejtjet e paraqitura nga anëtarët e komisionit, ajo u deklarua se do ta votojë projektligjin për miratim në parim, për arsye se shumë procese të institucioneve kosovare varen nga hyrja në fuqi e projektligjit.

Albulena Haxhiu - theksoi se pjesëmarrja e saj në komision nuk përfaqëson komisionin për legjislacion, por për shkak të rëndësisë së projektligjit ka interesim të informohet me arsyen për hartimin e projektligjit, sidomos duke shprehur domosdoshmërinë që projektligji duhet të diskutohet në format më të madh. Në këtë kontekst, ajo tha se do të ishte e arsyeshme që projektligjin ta shqyrtojnë dy komisione, përfshirë këtu Komisionin për Legjislacion. Mendimi i saj, për projektligjin është hartimi i dobët i tekstit, të merret parasysh që gjatë hartimit të projektligjeve teksti t'i përshtatet rrethanave dhe të jetë në përputhje me interesat e qytetarëve të Kosovës. Edhe pse është shfaqur domosdoshmëria e hartimit të një numri të madh të amendamenteve për projektligjin, ligji nuk do të mund të implementohet për shkak të tekstit të dobët, që do të sjellë probleme serioze në implementimin praktik. Meqë, Kuvendi nuk mund të përmirësojë tekstin në tri versionet, ajo propozoi që projektligji të kthehet në ripunim në Qeveri, në mënyrë që të inkorporohen vërejtjet dhe të harmonizohet teksti në të tri gjuhët.

Jelena Bontic - tha se interesimi dhe vërejtjet për projektligjin dëshmojnë rëndësinë që ka projektligji. Ajo u deklarua se do ta votojë miratimin e tij, ndërsa pas miratimit nga Kuvendi do t'i jep vërejtjet e saj.

Zafir Berisha - duke u pajtuar me diskutimet e anëtarëve të komisionit për vërejtjet në projektligj, pyeti ministrin, se hyrja në fuqi e projektligjit a mos do të sjellë kolizion me ligjet e tjera dhe a mos duhet të bëhet pastaj plotësim- ndryshimi i ligjeve të tjera në fuqi, në mënyrë që t'i shmangemi kolizionit të ligjeve.

Sadri Ferati - tha se në bazë të vërejtjeve që u shpalosen nga anëtarët e komisionit, se për projektligjin duhet hartuar një numër i madh i amendamenteve, pastaj u deklarua se do ta votojë projektligjin për arsye të ecurive procedurale, ndërsa për votim në seancë, tha se do të pret qëndrimin e grupit parlamentar të cilin e përfaqëson.

Shqipe Pantina - Në bazë të diskutimeve dhe vërejtjeve që anëtarët e komisionit i dhanë është konkluzion i përgjithshëm që projektligji duhet të ndryshohet nen për nen dhe në këtë kontekst do të bëhej projektligj i Kuvendit.

Zenun Pajaziti – Për arsye të rëndësisë që ka reforma e administratës publike dhe me qëllim të krijimit të një administrate publike të avancuar dhe kualitative, ai iu propozoi anëtarëve të komisionit që projektligji të miratohet.

Mahir Yagcilar – Projektligji nuk është politik, është projektligj për administratën publike me një qasje të re në terminologjinë e re, që reflekton procedurat për administratën e shtetit të Kosovës, ndërsa për vërejtjet në projektligj shprehu gatishmërinë për bashkëpunim.

Konstatim: Komisioni miratoi në parim Projektligjin për Procedurën e përgjithshme administrative me 5 vota “Për”: Zenun Pajaziti, Xhevahire Izmaku, Sadri Ferati, Jelena Bontic dhe Kujtim Paçaku; 2 vota “Kundër”: Pal Lekaj dhe Shqipe Pantina; dhe 1 votë “Abstenim” Zafir Berisha dhe nxori rekomandimin si në vijim:

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3.6.2015, shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 05/L-31, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji nr.05/L-31, për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional shqyrtoi projektligjin në parim, para leximit të parë në mbledhje plenare, dhe Kuvendit i paraqet raportin me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr.05/L-31, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54, të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

4. Të ndryshme.

Shqipe Pantina kërkoi nga Zyra Koordinuese që diskutimi i saj i mbledhjes së 20 majit 2015, kur u shqyrtua raporti i RTK-së të rishkruhet më i detajuar.

Zafir Berisha deklaroi se në mbledhjen kur është shqyrtuar raporti i RTK-së, nuk është votuar në mungesë të kuorumit, se ai kishte dalë nga mbledhja pasi që kryetari i komisionit nuk ka propozuar votimin e raportit.

Mbledhja përfundoi në ora:14:30

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Zenun Pajaziti
